

## **INFORMACION PRAKTIK PËR RASTET E PËRJASHTIMIT NGA PAGESA E TAKSËS SË AMBALAZHIT PLASTIK (TAM)**

**Baza ligjore:** Ligji 9975, date 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar (Neni 4 pika 8 dhe neni 9 pika 4) dhe Udhëzimi nr.26, datë 04.09.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar Neni 2.8.8

### **RASTI 1**

**Përfitues:** Subjektet që importojnë lëndë të para plastike për prodhim produktesh finale që nuk paguajnë normalisht taksë plastike në momentin e importit (përveç subjekteve të përmendur në rastin 2 deri 5 si më poshtë)

**Procedura:** Me regjistrim në sistemin Asycuda World (**kodi shtesë JPP**) nga Sektori i Tarifës.  
Dërgohet nga subjekti ose agjencia doganore përfaqësuese një email në adresën [starifa.dpd@dogana.gov.al](mailto:starifa.dpd@dogana.gov.al) për importin objekt përjashtimi. Regjistrimi kryhet nëse është plotësuar dokumentacioni si me poshtë.

### **Mallrat dhe Kodet tarifore që përfitojnë përjashtim nga TAM”:**

Lëndët e para në forma primare apo artikujt e tjerë të importuar, të përfshira në kodet nga **3901 deri 3914** të NKM-së, të cilat përdoren si plotësues teknologjik, lëndë të para aditive (agregate lidhëse), apo si material për prodhimin e produkteve që nuk kategorizohen si artikuj plastikë.

### **Dokumentacioni i nevojshëm:**

Dërgimi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me shkresë zyrtare nga Drejtoria Rajonale Tatimore (ku ushtron veprimtarinë subjekti) i:

- kopjes së dosjes për subjektin importues i cili prodhon mallra dhe materiale jo plastike;
- autorizimit me shkrim për mos pagesën e taksës për importimin nga vetë prodhuesi për qëllime prodhimi të mallrave jo plastike.

### **RASTI 2**

**Përfitues:** Subjektet që importojnë lëndë të para plastike dhe artikuj plastik për:

- prodhimin e polisterolit;
- prodhimin e dyerve dhe dritareve në funksion të eficiencës së energjisë.

**Procedura:** Me regjistrim në sistemin Asycuda World (**kodi shtesë JPB**) nga Sektori i Tarifës.  
Dërgohet nga subjekti ose agjencia doganore përfaqësuese një email në adresën [starifa.dpd@dogana.gov.al](mailto:starifa.dpd@dogana.gov.al) për importin objekt përjashtimi. Për kodet tarifore

3920 30 00, 3921 11 00, 3916 20 00 duhet dërguar me email dhe fatura e mallit.

Regjistrimi kryhet nëse është plotësuar dhe dokumentacioni në vijim dhe nëse objekti veprimtarisë së subjektit është prodhimi i polisterolit, prodhimi i dyerve dhe dritareve në funksion të eficiencës së energjisë.

#### **Mallrat dhe Kodet tarifore që përfitojnë përjashtim nga TAM”:**

Lëndët e para në forma primare për prodhimin e polisterolit (EPS expanded polysterene) **3901 deri 3914 të NKM-së**, paneleve, pllaka polistirenit (XPS extruder polystyrene), të përfshira në kodet **3920 30 00** – prej polimereve të stirenit dhe **3921 11 00** – – prej polimereve të stirenit, si dhe profileve PVC, të përfshira në kodin **3916 20 00** – prej polimereve të vinil kloridit, të NKM-së.

#### **Dokumentacioni i nevojshëm:**

- kopjes së dosjes për subjektin importues i cili prodhon mallra dhe materiale jo plastike;
- autorizimit me shkrim për mos pagesën e taksës për importimin nga vetë prodhuesi për qëllime prodhimi të mallrave jo plastike.

### **RASTI 3**

**Përfitues:** Subjektet që importojnë lëndë të para plastike për prodhimin e sfungjerit dhe importin e sfungjerëve.

**Procedura:** Me regjistrim në sistemin Asycuda World **(kodi shtesë JPS)** nga Sektori i Tarifës.  
Dërgohet nga subjekti ose agjencia doganore përfaqësuese një email në adresën [starifa.dpd@dogana.gov.al](mailto:starifa.dpd@dogana.gov.al) për importin objekt përjashtimi.

Regjistrimi kryhet nëse është plotësuar dhe dokumentacioni në vijim dhe nëse objekti veprimtarisë së subjektit është prodhimi dhe importimi i sfungjerit.

#### **Mallrat dhe Kodet tarifore që përfitojnë përjashtim nga TAM”:**

Lëndët e para në forma primare për prodhimin e sfungjerëve të përfshira në kodet nga **3901 deri 3914** të NKM-së.

#### **Dokumentacioni i nevojshëm:**

Dërgimi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me shkresë zyrtare nga Drejtoria Rajonale Tatimore (ku ushtron veprimtarinë subjekti) i:

- kopjes së dosjes për subjektin importues i cili prodhon mallra dhe materiale jo plastike;
- autorizimit me shkrim për mos pagesën e taksës për importimin nga vetë prodhuesi për

qëllime prodhimi të mallrave jo plastike.

#### RASTI 4

**Përfitues:** Subjektet që importojnë artikuj plastikë për industrinë e mobilierisë.

**Procedura:** Me regjistrim në sistemin Asycuda World (**kodi shtesë JPM**) nga Sektori i Tarifës.

Dërgohet nga subjekti ose agjencia doganore përfaqësuese një email në adresën [starifa.dpd@dogana.gov.al](mailto:starifa.dpd@dogana.gov.al) për importin objekt përjashtimi. Për kodet tarifore të kreut **3920** dhe **3921** dhe **kreut 3926 30** si dhe për kodin tarifor **3926 90 97** duhet dërguar me email dhe fatura e mallit.

Regjistrimi kryhet nëse është plotësuar dhe dokumentacioni në vijim dhe nëse objekti veprimtarisë së subjektit është për industrinë e mobilierisë.

#### **Mallrat dhe Kodet tarifore që përfitojnë përjashtim nga TAM”:**

Lëndët e para në forma primare me përmbajtje proteinike të forta të përfshira në kodet nga **3901 deri 3914** apo importimi i artikujve të cilët përdoren në industrinë e mobilierisë të klasifikuara në krahët **3920** – *pllaka, fleta, filma, krisafe dhe shirita të tjerë, prej plastike, jocelulare dhe jo të perforcuara, jo të laminuara, të pambështetura apo të pakombinuara në mënyra të ngjashme me materiale të tjera* dhe **3921** – *pllaka, fleta, filma, krisafe dhe shirita të tjera, prej plastike, nënkreun 3926 30 -- përshtatjet për mobilieritë dhe kodin 3926 90 97 --- -- të tjera.*

#### **Dokumentacioni i nevojshëm:**

Dërgimi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me shkresë zyrtare nga Drejtoria Rajonale Tatimore (ku ushtron veprimtarinë subjekti) i:

- kopjes së dosjes për subjektin importues i cili prodhon mallra dhe materiale jo plastike;
- autorizimit me shkrim për mos pagesën e taksës për importimin nga vetë prodhuesi për qëllime prodhimi të mallrave jo plastike.

#### RASTI 5

**Përfitues:** Subjektet që importojnë lëndë të para plastike dhe proteinike të fortë dhe zorrë artificiale për prodhimi sallami.

**Procedura:** Me regjistrim në sistemin Asycuda World (**kodi shtesë JPZ**) nga Sektori i Tarifës.

Dërgohet nga subjekti ose agjencia doganore përfaqësuese një email në adresën [starifa.dpd@dogana.gov.al](mailto:starifa.dpd@dogana.gov.al) për importin objekt përjashtimi. Për kodet tarifore të nën kreut **3917 10** dhe **3926 30** si dhe për kodin tarifor **3926 90 97** duhet dërguar me email dhe fatura e mallit.

Regjistrimi kryhet nëse është plotësuar dhe dokumentacioni në vijim dhe nëse objekti veprimtarisë së subjektit është për industrinë e prodhimit të sallameve.

**Mallrat dhe Kodet tarifore që përfitojnë përjashtim nga TAM”:**

Lëndët e para në forma primare me përmbajtje proteinike të forta të përfshira në kodet nga **3901 deri 3914** apo materialet celuzoike të kodit **3917 10** – *zorrë artificiale* (mbajtësit e sallamit) prej proteinave të forta apo prej materialeve celulozike të NKM-së.

**Dokumentacioni i nevojshëm:**

Dërgimi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me shkresë zyrtare nga Drejtoria Rajonale Tatimore (ku ushtron veprimtarinë subjekti) i:

- kopjes së dosjes për subjektin importues i cili prodhon mallra dhe materiale jo plastike;
- autorizimit me shkrim për mos pagesën e taksës për importimin nga vetë prodhuesi për qëllime prodhimi të mallrave jo plastike.
-